



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

UNIVERSITETI

“FAN S. NOLI”, KORÇË

RAPORT FINAL

GRUPI AUDITIT

JETON SHEHU

MERITA TËRSHANA

NËNTOR-DHJETOR 2019

RAPORT FINAL

Mbi

“Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime, në arritjen e objektivave”.

I.- HYRJE

Data e përgatitjes së Raportit Final 20.01.2020

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.9678/1 prot datë 06.11.2019

Subjekt i auditimit kanë qenë fushat e sistemet:

Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme drejtimi dhe struktura organizative

Sistemi i pagave

Hartimi e zbatimi i buxhetit

Prokurimi i fondeve publike

Mbajtja e kontabilitetit financiar

Menaxhimi i aktiveve

Përdorimi fondeve për bursat

krijimi dhe përdorimi i të ardhurave

Ngarkesat mësimore

Funksionimi i Bordit të Administrimit.

Baza ligjore

- Ligji Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Manuali i auditimit të brendshëm;
- Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”
- Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- VKM, Nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;
- VKM, Nr.918, datë 29.12.2014, “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 25/2018, date 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- Standardet kombëtare të kontabilitetit;
- Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencorë në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimet e Këshillit të Ministrave “Për pagat”;
- Vendimet e Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë”;
- Udhëzim i Ministrisë së Arsimit, nr.20 datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”.
- Udhëzim i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”.
- Akte ligjore e nënligjore “Paketa Studenti”.

Objektivi i angazhimit të auditimit

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime, në arritjen e objektivave.

Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit dhe dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve
Dhënie e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

- nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare,

- auditimin e sistemeve financiare përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret

- Është programuar për auditim Universiteti "Fan S. Noli", Korçë për shkak të periudhës së gjatë të pa audituar, transaksioneve të shumta dhe fondeve që ka në dispozicion ky subjekt si dhe ky institucion ishte i planifikuar për auditim në planin vjetor të auditimit për vitin 2019, hartuar që në muajin tetor 2018.
- Përbërja e grupit të auditimit:
 - Jeton Shehu Përgjegjës grupi
 - Merita Tërshana Anëtare
- Periudha e audituar: 01.01.2018 deri më 31.10.2019
- Auditimi ka filluar më: 06.11.2019
- Auditimi ka përfunduar: 23.11.2019

Në përfundim të procesit të kryerjes së auditimit u përpilua projekt raporti, i cili me shkresën nr.9678/2, datë 30.12.2019 i është dërguar Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, me shkresën nr.2/1, datë 10.01.2020, shkresë e cila vjen në MASR me datë 14.01.2020, rregjistruar në protokoll me nr.9678/3, është prononcuar mbi disa problematika të ngritura në projekt raport. Grupi i auditit pasi analizoi pretendimet e ngritura nga Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, duke i marrë në konsideratë ato, përgatit këtë raport final auditimi,

II.- Përmbledhje ekzekutive

Universiteti "Fan S.Noli", Korçë, është një institucion publik, autonom, laik, kërkimor shkencor dhe didaktik i arsimit të lartë që ka për detyrë parësore kërkimin shkencor dhe didaktiken, aktivitete të drejtuara për të ndjekur një dituri kritike të hapur në lidhjen midis kulturave, në respektim të lirisë së shkencës dhe mësimit.

- Mbron dhe rinovon pasurinë e tij kulturore duke ju përgjigjur pretendimeve të ndryshme të shprehura nga shoqëria.

- Ushtron funksionet themelore të kërkimit shkencor dhe të didaktikës, për çdo tipologji të formimit të nivelit të lartë, përfshirë orientimin, formimin e përhershëm dhe përditësimin kulturor e profesional, veprimtaritë bazë dhe/apo plotësuese për to, si dhe kërkimin shkencor për çështjet me interes publik dhe/apo privat.

- Garanton punonjësve akademikë mundësi të barabarta për të përfituar nga financimet për kërkimin shkencor.

- promovon dhe nxit dimensionin ndërkombëtar të studimeve, të mësuarit dhe të kërkimit shkencor. UE konsideron si një nga detyrat e tij themelore edhe zhvillimin e shkëmbimeve ndërkombëtare të pedagogëve dhe të studentëve si dhe pranimin e formimit të studentëve të huaj.

-Ndjek qëllimet e tij në përputhje të plotë me dinjitetin human, ne pluralizmin e ideve dhe ne transparencën e procedurave. I garanton çdo pedagogu autonominë e kërkimit dhe lirinë e mësimdhënies, sipas dispozitave të këtij Statuti, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me të drejtën e studimit dhe me pozitën juridike përkatëse.

- Promovon, organizon dhe kryen shërbime formuese dhe kulturore në territorin e qarkut të Korçës, në të gjithë vendin, si dhe jashtë tij.

- Organizon brenda tij vlerësimin e arritjes së qëllimeve të tij institucionale.

- Garanton shprehjen e lirë të ideve akademike, i krijon kushte personelit dhe studentëve për shprehjen dhe promovimin e lirë të mendimeve të tyre.

-Krijon, zhvillon, përcjellë dhe mbron dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor,

-Formon specialistë të lartë dhe përgatitë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend.

Grupi i auditimit nga dokumentacioni i shqyrtuar në mënyrë të përmbledhur evidenton si gjetje dhe konkluzione të rëndësishme sa më poshtë:

1.- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme:

Nuk janë realizuar rekomandimet e lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si:

A.- Masa organizative

a.- Institucioni të marrë masa për vitin akademik 2017-2018 që pagesat e personelit akademik për orët e mbingarkesës mësimore, të kryhet në përputhje të plotë me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën që ne audituam rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar për vitin akademik 2017-2018.

Sipas këtyre vendimeve organet kolegjiale kanë miratuar pagesën e orëve mësimore mbi normën e ngarkesës deri në 200 orë. Sipas të dhënave në pasqyrën (Pjesë e dosjes së auditimit) rezulton se janë paguar mbi 30 % të normës së ngarkesës 16.504 orë me një efekt financiar 15.750.114 lekë.

b.- "Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të marrin të gjitha masat për ngritjen e strukturës së Auditimit të Brendshëm"

B.- "Masa për shpërblim dëmi"

a.- Nga Universiteti "Fan S.Noli", Korçë të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në shumën 1.182.631 lekë përfituar më shumë nga anëtarët e Bordit të administrimit. (Këtë shumë KLSH e ka llogaritur si diferencës e shumës së marë në fakt me vlerën 8.000 lekë që kanë marrë anëtarët e Këshillit të Administrimit)

Ky rekomandim nuk është zbatuar pasi drejtuesit e Universitetit "Fan S.Noli", Korçë pretendojnë së në këtë rast rekomandimi i KLSH-së nuk është i mbështetur ligjërisht.

b.- Nga Universiteti "Fan S.Noli", Korçë të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në shumën 56.100 lekë të shpenzuara për pritje përcjellje me rastin e 45 vjetorit të Universitetit "Fan S.Noli", Korçë.

C.- Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike

a.- Strukturat e drejtimit të Universitetit "Fan S.Noli", Korçë të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për shumat e shpenzuara prej 1.382.000 lekë konsideruar si shpenzime jo efektive për buxhetin e shtetit (Flitet për shmangie nga realizimi i procedurës së prokurimit për blerje kompjuterë dhe pajisje).

Në vazhdimësi në kuadër të Kërkimit Shkencor, sipas rekomandimit të KLSH-së janë respektuar me rigorozitet të gjitha kërkesat ligjore (Grup vlerësimi për projektet, proces verbal, relacion nga organet e kërkimit shkencor, Urdhër marrje në dorëzim, procesverbal marrje në dorëzim...etj).

b.- Strukturat e drejtimit të Universitetit "Fan S.Noli", Korçë të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për shumat e shpenzuara prej 712.421 lekë për pagesa për punë jashtë kohës normale, konsideruar si shpenzime jo efektive për buxhetin e shtetit.

c.- Strukturat e drejtimit Universitetit "Fan S.Noli", Korçë të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për shumat e shpenzuara prej 1.371.491 si shpenzime jo efektive në buxhetin e shtetit, pasi janë nxjerrë jashtë përdorimit 272 copë bojë printeri e fotokopje pa kryer asnjë analizë dhe nxjerrje përgjegjësie.

D- Masa disiplinore1.-Fillimi i procedurave për dhënien e masave "Vërejtje me paralajmërim" deri në "Largim nga puna", për:

- Gjergji Përmeti – me detyre Drejtori i Burimeve Njerëzore
- Oriana Theodhori – me detyrë ish kryetare e Këshillit të administrimit
- Elmis Simo – me detyrë Anëtare komisionit të asgjësimit të Materialeve

Nga ana e Rektorit të Universitetit nuk janë marrë masa disiplinore, pasi nuk sheh me vend për dhënien e masave të rekomanduara.

Niveli i riskut: I ulët

Konkluzion: Për zbatimin e rekomandimeve të pranuar, drejtuesit e universiteti kanë marrë të gjitha masat duke hartuar programin e punës, kanë nxjerrë urdhrat përkatës dhe realizimi i këtyre rekomandimeve është në proces.

Rekomandim: Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe të pranuar nga Universiteti të njoftohet Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në Masr

Në mënyrë analitike do të shtjellohen më poshtë:

2. Për hartimin e zbatimit e buxhetit:

Janë bërë pagesa për orë jashtë orarit pa marrë më parë autorizim nga Ministri i financave, kërkesë e udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011.

Me urdhër shpenzimin nr.312, datë 18.1.2018 më shumë 417.811 lekë. Në këtë rast janë kryer pagesa për orë jashtë orarit për 14 punonjës, nga të cilët 5 janë punonjës të IT dhe 10 punonjës të sekretarisë mësimore. Puna që kanë kryer jashtë orarit është vlerësuar si kohë operationale dhe janë paguar për këtë qëllim. Për punonjësit e IT orët e punuara jashtë orarit duhet të kompesoheshin me ore ditë pushimi.

Sipas pretendimeve të universitetit këto pagesa si për vitin 2018 dhe në vitin 2019 janë bërë vetëm për sekretaritë mësimor dhe punonjësit e IT në periudhën e regjistrimit, ndërsa për personelin e shërbimit dhe personelin administrativ këtë vit nuk janë bërë pagesa.

Niveli i riskut: I mesëm

Konkluzion: Kjo situatë ka ardhur për shkak të mos njohjes së kuadrit rregullator për pagesat e orëve jashtë orarit të kryera nga administrata e Institucionit.

Rekomandim: Në të gjitha rastet e pagesave për orët jashtë orarit të kërkohet miratim nga Ministri i financës në zbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011.

Sqarim: Sipas observacionit të paraqitur nga drejtuesit e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë pagesat për orët jashtë orarit për vitin 2019, pas sugjerimit të bërë nga grupi i auditit janë bërë në zbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011 të Ministrisë së Financave. Është paraqitur bashkëngjitur dokumentacioni ligjor justifikues për këtë pagesë dhe grupi i auditimit e pranon të ligjshëm këtë argument.

3.- Në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave:

Duke analizuar të ardhurat e realizuara të Universitetit gjatë 2 viteve të fundit ato janë ulur, në një masë të konsiderueshme, pavarësisht nga hapja e programeve të reja të studimit, kjo për faktin se:

-Numri i studentëve ka ardhur në ulje.

-Numri i studentëve që përfitojnë nga përjashtimi studentët tarifës së shkollimit ka ardhur duke u rritur.

Por theksojmë faktin se për studentet që përfituan sipas kërkesave të tyre për tarifën e shkollimit dhe zbatimit të paketës studentit buxheti i shtetit e ka kompensuar universitetin për efektet financiare

4.- Pagesa e orëve mbi normën e ngarkesës

Janë bërë pagesa për orët mbi normën e ngarkesës në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik të institucioneve Publike të Arsimit të Lartë.

Pagesat janë bërë me:

- Urdhër shpenzimin nr.235, dhe 236, datë 03.09.2018 ne shumën 35.116.894 lekë.
Pagesat janë bërë sipas vendimeve të organeve kolegjinale:

- Vendim i Senatit Akademik nr.32, datë 05.10.2017

- Vendim i Bordit të Administrimit nr.20, datë 12.10.2017.

Sipas këtyre vendimeve organet kolegjinale kanë miratuar pagesën e orëve mësimore mbi normën e ngarkesës deri në 200 orë. Sipas të dhënave në pasqyrën (Pjesë e dosjes së auditimit) rezulton se janë paguar mbi 30 % të normës së ngarkesës 16.504 orë me një efekt financiar 15.750.114 lekë.

Për vitin akademik 2018-2019 pagesën për orët mbi normën e ngarkesës e rregullon Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".

Sipas pikës II, 1paragrafi i trete thuhet që orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200 orë, ndërsa në pikën III, 2 "Dispozita të fundit thuhet "Personeli akademik i cili angazhohet në veprimtaritë e parashikuara në pikën 12 (Elementët e veprimtarive jashtë auditorit në ndihmë të procesit mësimor në IAL-të publike), Paguhen për ngarkesën e parashikuar si orë suplementare. Në këtë rast udhëzimi nuk e nxjerr qartë se sa orë do të paguhen si ore suplementar ne këtë rast kur pedagogu ka realizuar 200 orë mbi normën e ngarkesës në auditor

Konkluzion: Kjo situatë ka ardhur për shkak të:

-Mos zbatimit të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik të institucioneve Publike të Arsimit të Lartë.

-Dhe problemeve në interpretim që ka shkaktuar Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".

Niveli i riskut: I lartë

Konkluzion: Kjo situatë ka ardhur për shkak të:

-Mos zbatimit të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik të institucioneve Publike të Arsimit të Lartë.

-Dhe problemeve në interpretim që ka shkaktuar Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".

Rekomandim:

-Drejtuesit e Universitetit të nxjerrin përgjegjësitë për këto raste të përdorimit të fondeve buxhetore në mënyrë joefektive.

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të pranonohet për të gjitha rastet për pagesat e orëve mbi normën e ngarkesës kur kryen jo në auditor

Opinion i Përqjithshëm

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion evidentohet se sistemet e kontrollit të brendshëm funksionojnë në përputhje me sistemet bazë. Fondet e vëna në dispozicion nga MASH-i përputhen me kërkesat e subjektit si dhe me projektbuxhetin e paraqitur nga vet institucioni. Përmirësimi i këtyre sistemeve bëhet i mundur me zbatimin e rekomandimeve që do të lejë grupi i auditimit për çdo fushë e sistem

Grupi i auditit konstatoi se në fushën e veprimtarisë për menaxhimin e burimeve dhe asteve në drejtim të realizimit të objektivave dhe misionit në këtë institucion respektohet kuadri rregullator ne fuqi, me gjithë atë u evidentuan fusha që kërkonin përmirësim në të ardhmen, të cilat në mënyrë analitike do trajtohen në vijim.

III.- Metoda e Auditimit

U përdorën metoda dhe teknika të auditimit:

"Testim hap pas hapi" duke zgjedhur një numër të caktuar transaksionesh për të parë se si njësia publike e audituar i përmbahet procedurave të caktuara të audituara.

“Metoda e ekzaminimit” ku përfshihen procedura testimi si dhe gjykim profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve

“Metoda e intervistimit”.

IV.- Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet për çdo sistem.

1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme:

- Programet e hartuara nga subjekti për zbatimin e rekomandimeve.
- Realizimi i rekomandimeve.

Auditimi i fundit në Universitetin “Fan S.Noli”, Korçë është realizuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas programit të me nr.202/1, datë 23.02.2018.

Është audituar periudha 01.01.2016 – 31.12.2017.

Auditimi është realizuar nga data 20.02.2018 deri 30.04.2018 (Për 2 muaj e 10 ditë).

Grupi i auditit i përbërë nga 5 auditues.

Në përfundim të procesit të auditimit me shkresën nr.202/1, datë 30.06.2018 është dërguar në universitet Raporti përfundimtar dhe rekomandimet, sipas të cilit janë lënë rekomandime si më poshtë:

- 2 rekomandime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi
- “Masa organizative” 29 rekomandime
- “Masa për shpërbllim dëmi” 9 rekomandime
- “Masa për përmirësimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike” 8 rekomandime
- Masa disiplinore:
 - o I propozohet rektorit që të jepet masë nga “Vërejtje me paralajmërim” deri largim nga puna për 2 punonjës.
 - o I propozohet Administratorit që të jepet masë nga “Vërejtje me paralajmërim” deri largim nga puna për 8 punonjës.
- Masa administrative:
 - o Kërkohej që Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë të drejtohet APP për marrjen e masave me gjobë nga 50.000 deri 100,000 lekë për 15 punonjës dhe 100.000 lekë për një punonjës.

Lidhur me raportin final dhe rekomandimet Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë, i është drejtuar zyrtarisht Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KLSH me shkresën nr.450, datë 26.06.2019 ka lëshuar një autorizim mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, sipas të cilit janë caktuar 2 auditues që do të realizojnë këtë mision nga data 27.06.2018 deri 03.07.2019.

Në përfundim të verifikimit është paraqitur akt verifikimi sipas të cilit bëhet analiza e zbatimit të rekomandimeve.

Për këtë aktverifikimi Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë me shkresën nr.1185/1, datë 09.07.2019 “Pretendime dhe sqarime”, i drejtohet KLSH-së duke ngritur pretendimet e tij dhe masat e mara për zbatimin e rekomandimeve.

Pas këtyre sqarimeve KLSH me shkresën nr.470/47, datë 14.08.2019 dërguar Universitetit “Fan S.Noli”, Korçë, me lëndë “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme, duke konkluduar, në lënien e rekomandimeve përfundimtare.

Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën në vazhdim për zbatimin e rekomandimeve rezultoi:

Nr. i Gjetjes 1	
Subjekti i Audituar	Drejtoria Ekonomike

Njësitë e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> - Administratori - Drejtoria Ekonomike - Drejtoria e Kurrikulave, Sig. Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor
Përmbledhja e bazës ligjore	<p>-Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik të institucioneve Publike të Arsimit të Lartë.</p> <p>- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 463, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa të vendimit nr.511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave,"Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet buxhetore.</p> <p>- udhëzimi i Ministrisë së Financës nr. 16, datë 20.07.2011 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.463 datë 16.06.2011.</p>
Përshkrimi i gjetjes	<p>Nuk janë realizuar rekomandimet e lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si:</p> <p>A.- Masa organizative</p> <p>1.- Institucioni të marrë masa për vitin akademik 2017-2018 që pagesat e personelit akademik për orët e mbingarkesës mësimore, të kryhet në përputhje të plotë me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën që ne audituam rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar për vitin akademik 2017-2018.</p> <p>Pagesat për orët mbi normën e ngarkesës janë bërë në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit të MASH Nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik të institucioneve Publike të Arsimit të Lartë.</p> <p>Pagesat janë bërë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Urdhër shpenzimin nr.235, dhe 236, datë 03.09.2018 ne shumën 35.116.894 lekë. <p>Pagesat janë bërë sipas vendimeve të organeve kolegjiale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendim i Senatit Akademik nr.32, datë 05.10.2017 - Vendim i Bordit të Administrimit nr.20, datë 12.10.2017. <p>Sipas këtyre vendimeve organet kolegjiale kanë miratuar pagesën e orëve mësimore mbi normën e ngarkesës deri në 200 orë. Sipas të dhënave në pasqyrën (Pjesë e dosjes së auditimit) rezulton se janë paguar mbi 30 % të normës së ngarkesës 16.504 orë me një efekt financiar 15.750.114 lekë.</p> <p>2.- "Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të marrin të gjitha masat për ngritjen e strukturës së Auditimit të Brendshëm"</p> <p>B.- "Masa për shpërblim dëmi"</p> <p>1.- Nga Universiteti "Fan S.Noli", Korçë të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në shumën 1.182.631 lekë përfituar më shumë nga anëtarët e Bordit të administrimit. (Këtë shumë KLSH e ka llogaritur si diferencës e shumës së marë në fakt me vlerën 8.000 lekë që kanë marrë anëtarët e Këshillit të Administrimit)</p> <p>Ky rekomandim nuk është zbatuar pasi drejtuesit e Universitetit "Fan S.Noli", Korçë pretendojnë se në këtë rast rekomandimi i KLSH-së nuk është i mbështetur ligjërisht. Bordi i Administrimit me shkresë nr. 1355, datë 09.07.2018 i është drejtuar MASR-së për ndryshimet dhe rregullimet e domosdoshme të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Bordi, gjithashtu ka rënë dakord që në muajin mars 2018 që t'i mbahen të pezulluara pagesat deri në momentin e zgjidhjes së problematikës dhe pas kthimit të përgjigjes të dërguar me shkresë nr.7385/1, datë 28.09.2018, ka marrë vendimin nr.572, datë 28.09.2018 "Për përcaktimin e pagesës së anëtarëve të Bordit".</p> <p>Pas nxjerrjes së VKM-së nr:656, date 06.12.2018 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme</p>

të njësive të qeverisjes qendrore”, pika 5, Bordi i Administrimit ka marrë vendimin nr.742, date 06.12.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve në Senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit, të Universitetit “Fan S.Noli” Korçë”. Masa e shpërblimit të Bordit është në përputhje të plotë me përcaktimet e kësaj VKM.

2.- Nga Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik në shumën 56.100 lekë të shpenzuara për pritje përcjellje me rastin e 45 vjetorit të Universitetit “Fan S.Noli”, Korçë.

Për realizimin e shpenzimeve me rastin e 45 vjetorit të Universitetit “Fan S.Noli”, Korçë është marrë dhe vendim nga Bordi i Administrimit nr.577, datë 10.10.2018.

Rektori i UNFSK i është drejtuar Administratorit të Universitetit me shkresën nr.1412 Prot., datë 18.07.2018, në cilën argumenton se zhvillimi i procedurave të prokurimit dhe përgatitja e dokumentacionit përkatës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi nuk është as detyrë dhe as kompetencë e rektorit të universitetit. Rektori i universitetit nuk është personi përgjegjës për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procedurave të prokurimit dhe zhvillimin e tyre sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Pas shqyrtimit të argumenteve dhe dokumentacionit të paraqitur në Rektori, *Megjithëse me Vendimin e Bordit të Administrimit Nr.577, datë 01.10.2018, pika 16, është vendosur të mos e zbatohet rekomandimi për arkëtimin e dëmit ekonomik prej 56,100 lekësh nga ana e Rektorit.*

Ne lidhje me këtë Shërbim nga Universiteti janë respektuar Normativat sipas Kuotave të përcaktuara në VKM nr.243, datë 15.5.1995, “Për pritjet, përcjelljet dhe trajtimin që u bëhen delegacioneve të huaja”, ndryshuar.

Pagesa për subjektin në vlerën: 261.700 leke pa TVSH (pra në total është më poshtë se kuotat e lejuara).

- Pritje zyrtare (kokëti) në vlerën: 103.000 leke pa TVSH (pagesa e kryer)
- Diferenca me kuotën e lejuar 103.000 leke – 67.500 leke = 35.500 leke dhe jo 51.600 leke.

Kjo diferencë është si rezultat i shpërndarjes së çmimeve në përshkrimi i mallrave dhe shërbimeve në fatura nga subjekti, ku dy zëra janë nën kuotat e lejuara dhe zëri tjetër është mbi kuotë pasi shërbimi është kryer në ambientet e universitetit (jo tek lokali i subjektit), pra përfshihen kostot e transportit të mallrave të koktejit, te tavolinave - skabot, shërbimi i ofruar nga kamerieret e subjektit, etj.

Për sa më sipër ky rekomandim nuk është pranuar për zbatim.

C.- Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike

1.- Strukturat e drejtimit të Universitetit “Fan S.Noli”, Korçë të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për shumën e shpenzuara prej 1.382.000 lekë konsideruar si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit (Flitet për shmangie nga realizimi i procedurës së prokurimit për blerje kompjuterë dhe pajisje).

Reagimi i drejtuesve të Universitetit në këtë rast:

Në lidhje me këtë rekomandim nga Universiteti kjo procedure është kryer në kuadër të Kërkimit Shkencor.

Në mbështetje të Udhëzimit Nr. 19, date 13.05.2011 “Për detajimin e buxhetit të Institucioneve publike të Arsimit të Lartë në Programin Për Kërkim Fundamental dhe Ekselencë” pika 14, në zbatim të ligjit Nr. 9643, dt. 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nen 7, pika d) shërbimet e kërkimit dhe të zhvillimit, rezultatet e të cilave shfrytëzohen nga të gjithë, përveç rasteve kur përfitimet i shkojnë vetëm autoritetit kontraktor për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme dhe me kusht

që shërbimi i kryer të paguhet plotësisht nga ky autoritet kontraktor, nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik.

Projekti nuk ka qene i shoqëruar me një vlerësim përfundimtar nga grupi i vlerësimit të projekteve pasi projekti nuk kishte përfunduar.

Përfituesit direkt:

Studentet e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Programit të Studimit "Histori-Gjeografi" Theksojmë se përfitues janë studentet në të gjitha ciklet e studimit të Programit "Histori -Gjeografi", nuk është përfitues AK për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme, (nuk është si një program biblioteke, sekretarie, apo magazinimi i cili përdoret për çështje të brendshme.) Studentet marrin dije dhe e transferojnë atë nëpërmjet mësimdhënies. Gjithashtu UK kryen dhe trajnime për mësuesit e arsimit parauniversitar, gjë e cila ndikon në rajonin e Korçës për transferimin e dijeve në komunitet.

Duke qene se fondet janë shpenzuar në kuadër të Kërkimit Shkencor, të cilat përjashtohen nga Ligji i prokurimit publik, pasi përfitues nuk është vetëm AK, ky rekomandim nuk mund të gjeje zbatim nga ana jone, referuar, legjislacionit.

Bordi i Administrimit me vendimin nr.577, datë 01.10.2018, pika 19, vendosi të mos e zbatojë rekomandimin e audituesve të KLSH-së.

Në vazhdimësi në kuadër të Kërkimit Shkencor, sipas rekomandimit të KLSH-së janë respektuar me rigorozitet të gjitha kërkesat ligjore (Grup vlerësimi për projektet, proces verbal, relacion nga organet e kërkimit shkencor, Urdhër marrje në dorëzim, procesverbal marrje në dorëzim...etj).

2.- Strukturat e drejtimit Universitetit "Fan S.Noli", Korçë të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për shumën e shpenzuar prej 712.421 lekë për pagesa për punë jashtë kohës normale, konsideruar si shpenzime jo efektive për buxhetin e shtetit.

Ky rekomandim nuk është realizuar.

Për përuarjen e audituar rezulton se janë bërë pagesa për orë jashtë orarit pa marrë më parë autorizim nga Ministri i financave, kërkesë e udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011.

Me urdhër shpenzimin nr.312, datë 18.1.2018 më shumë 417.811 lekë. Në këtë rast janë kryer pagesa për orë jashtë orarit për 14 punonjës, nga të cilët 5 janë punonjës të IT dhe 10 punonjës të sekretarisë mësimore. Puna që kanë kryer jashtë orarit është vlerësuar si kohë operationale dhe janë paguar për këtë qëllim. Për punonjësit e IT orët e punuara jashtë orarit duhet të kompensoheshin me ore ditë pushimi.

Sipas pretendimeve të universitetit këto pagesa si për vitin 2018 dhe në vitin 2019 janë bërë vetëm për sekretaritet mësimor dhe punonjësit e IT në periudhën e regjistrimit, ndërsa për personelin e shërbimit dhe personelin administrativ këtë vit nuk janë bërë pagesa.

3.- Strukturat e drejtimit Universitetit "Fan S.Noli", Korçë të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për shumën e shpenzuar prej 1.371.491 si shpenzime jo efektive në buxhetin e shtetit, pasi janë nxjerrë jashtë përdorimit 272 copë bojë printeri e fotokopje pa kryer asnjë analizë dhe nxjerrje përgjegjësie.

Në lidhje me këtë gjetje sasia e bojërave e nxjerre jashtë përdorimit gjate inventarizimit të viteve 2014, 2015, 2016, është kryer pasi një pjesë e tyre kanë qene gjendje në magazine prej një periudhe të gjate kohe, (kohë kur në Universitet zhvilloheshin konkurset e pranimit dhe përgatiteshin me mijëra teste, dhe më tej), një pjesë e tyre ka qene e pajisjeve të papërdorshme (fotokopje, printerë të dala jashtë përdorimi), dhe si rezultat këto bojëra kanë qene të papërdorshme.

	<p>Në vazhdimësi gjate procesit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit veprimet për këto faza janë përmirësuar dhe janë kryer sipas Udhëzimit Nr.30 /2011 të Ministrisë të Financave, kjo e pasqyruar dhe në Raportin e KLSH-së për procedurat e kryer për inventarizimin e vitit 2017. Në vazhdimësi referuar konstatimeve të Grupit të KLSH –se puna do të përmirësohet duke analizuar çdo veprim rast pas rasti.</p> <p>Në lidhje me këtë rekomandim zbatimi është i pamundur pasi këto mallra (stok) janë nxjerre jashtë përdorimit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>D- Masa disiplinore1.-Fillimi i procedurave për dhënien e masave “Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga puna”, për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjergji Përmeti – me detyrë Drejtori i Burimeve Njerëzore - Oriana Theodhori – me detyrë ish kryetare e Këshillit të administrimit - Elmis Simo – me detyrë Anëtare komisionit të asgjësimit të Materialeve <p>Nga ana e Rektorit të Universitetit nuk janë marrë masa disiplinore, pasi nuk sheh me vend për dhënien e masave të rekomanduara.</p>
Konkluzioni	Për zbatimin e rekomandimeve të pranuar, drejtuesit e universitetit kanë marrë të gjitha masat duke hartuar programin e punës, kanë nxjerrë urdhrat përkatës dhe realizimi i këtyre rekomandimeve është në proces.
Vlerësimi i riskut	I mesëm
Rekomandimi	Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe të pranuar nga Universiteti të njoftohet periodikisht Drejtorja e Auditimit të Brendshëm, në MASR
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	<i>Njoftime periodike për zbatimin e rekomandimeve</i>
Statusi i rekomandimit	<i>Ky rekomandim është pranuar</i>

KLSH ka lënë dhe dy rekomandime të cilat më parë, sipas akt verifikimit të datës 03.06.2019 i kishte verifikuar dhe certifikuar si të realizuara.

Opinion

KLSH në përfundim të procesit të auditimit, fillimisht ka dhënë 46 masa (Organizative, shpërbllim dëmi, eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike. Për 10 punonjës masa disiplinore. Për 16 punonjës masa administrative, dhe në fund me datën 14.08.2019 ka konkluduar me vetëm 9 masa (Nga të cilat në dy raste janë dhënë dy masa që më parë ishin konsideruar të realizuara.

2. Auditim i sistemit të drejtimit dhe strukturës organizative:

- struktura organizative e subjektit dhe organigrama e institucionit, është në përputhshmëri me legjislacionin dhe objektivat e institucionit;
- përputhja e kriterëve profesionale me kërkesat e vendit të punës për punonjësit aktualë dhe punësimet e reja;
- a trajnohet stafi për pozicionet e punës që ata kryejnë;
- ka vazhdueshmëri në përshkrimin e vendit të punës;
- a bëhet në vijimësi vlerësimi i performancës së punonjësve;
- harmonizimi i burimeve njerëzore ekzistuese me prurjet e reja;
- janë marrë masa për menaxhimin e riskut;
- punësimet bëhen sipas kriterëve të përcaktuara dhe eksperiencës së nevojshme;

Struktura organizative dhe organigrama e universitetit është hartuar në përputhshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi dhe objektivat e institucionit. Struktura dhe organigrama e universitetit është

miratuar me vendimin e Bordit të Administrimit nr.138, datë 12.03.2019, ndërsa numri i punonjësve sipas niveleve është miratuar me vendimin e Bordit të Administrimit nr.182, datë 03.04.2019 (Vendimet pjesë e dosjes së auditimit)

Përgjithësisht ka përputhje të kriteve profesionale me kërkesat e vendit të punës për punonjësit aktualë, ndërsa për punësimet e reja përputhja është e plotë;

Për kategori të caktuara të punonjësve ka patur trajnime për pozicionet e punës që ata kryejnë, si për personelin akademik ashtu dhe për personelin jo akademik;

Përshkrimet e vendeve të punës u bënë për herë të parë vitin e kaluar. Me hartimin e strukturës organizative dhe organigramës për vitin 2020 do të bëhet përshkrimi i vendeve të punës që eventualisht mund të ndryshojnë;

Edhe vlerësimi i performancës së punonjësve është bërë për herë të parë në vitin 2018. Ky vlerësim në vazhdimësi, do të bëhet çdo fund viti kalendarik;

Harmonizimi i burimeve njerëzore ekzistuese me prurjet e reja është një objektiv i mirëpërcaktuar nga ana e Universitetit. Për tri vitet e fundit 58 % e prurjeve të reja janë të moshës 25-35 vjet, (nga 43 të punësuar gjithsej, 23 janë të moshës 25-35 vjet).

Punësimi i personelit akademik bëhet në përputhje me nenin 64 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe nenin 40 të Statutit të universitetit. ndërsa punësimi i personelit ndihmës akademik bëhet në përputhje me nenin 66 të Ligjit nr. 80/2015. Kriteret për punësimin e personelit jo akademik propozohen nga njësia së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, neni 43, pika 4 i Statutit të universitetit.

Punësimi realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.

Procedura e konkurrimit përcaktohet me shpalljen e vendit të lirë të punës dhe për të zbatohen për aq sa janë të mundura, dispozitat e Kodit të Punës dhe ligjit për shërbimin civil.

Procedurat e punësimit bëhet në zbatim të nenit 50 të ligjit nr.9741 date 21.05.2007 "Per arsimin e larte në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me nenin 27, pika 2 të ligjit nr.10307 datë 22.07.2010.

Janë përcaktuar kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidatet për të tria kategoritë e personelit (mësimor, ndihmës mësimor dhe jo mësimor.

Rekrutimi personelit akademik në departamentet e fakulteteve të UE-së është kryer në zbatim të strukturës së miratuar si dhe Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe Kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë"

Numri i personelit të universitetit sipas niveleve për vitin 2019

1. Administrata e Rektoratit	48	punonjës
• Personel ndihmës akademik (3 me kohë të pjeshme)	19	"
• Personel administrativ	18	"
• Personel shërbimi dhe mirëmbajtje	11	"
1. Fakulteti Ekonomik	45	"
• Personel akademik	37	"
• Personel ndihmës akademik	6	"
• Personel shërbimi	2	"
2. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	63	"
• Personel akademik	54	"
• Personel ndihmës akademik	7	"
• Personel shërbimi	2	"
3. Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane	69	"

• Personel akademik	56	"
• Personel ndihmës akademik	10	"
• Personel shërbimi	3	"
4. Fakulteti i Bujqësisë	41	"
• Personel akademik	26	"
• Personel ndihmës akademik	6	"
• Personel shërbimi	1	"
• EDE	8	"
Gjithsej efektive	266	"
5. Personel akademik me kohë të pjesshme	119	"
Gjithsej Universiteti	385	punonjës

Struktura dhe organika analitike e administratës së Rektoratit

Viti 2019

1. Rektor (1 personel akademik)	-
2. Njësia e Auditit të Brendshëm	1
- Specialist njësie	1
3. Administrator	1
4. Zv. Rektor (2 personel akademik)	-
5. Shofer në rektorat (një shofer me kontratë)	2
6. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit & Promocionit	9
➤ Drejtor	1
➤ Sektori Juridik dhe Arkiv-protokollit	3
- Përgjegjës sektori (jurist)	1
- Specialist protokolli	1
- Specialist arkivi	1
➤ Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Promocionin	5
- Përgjegjës sektori	1
- Specialist për marrëdhëniet me jashtë	1
- Specialist për marrëdhëniet me publikun	1
- Specialist promocioni (me kohë të pjesshme)	2
7. Drejtoria e Kurrikulave, Sig. Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor	10
➤ Drejtor	1
➤ Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të cilësisë	5
- Përgjegjës sektori	1
- Specialist i Karrierës dhe Alumnit	1
- Specialist TI	1
- Specialist	1
- Specialist (me kohë të pjesshme)	1
➤ Sektori i projekteve, kërkimit shkencor dhe dixhitalizimit	4
- Përgjegjës sektori	1
- Specialist për botimet	1
- Specialist për projektet	1

- Specialist i Bibliotekës Universitare	1
8. Koordinator për formimin e vazhduar (1 pedagog)	-
9. Koordinator i Projektit Erasmus + (1 pedagog)	-
10. Drejtoria Ekonomike	18
➤ Drejtor	1
➤ Sektori i Investimeve dhe Prokurimeve	4
- Përgjegjës sektori	1
- Specialistë	3
➤ Sektori i Shërbimeve	13
- Përgjegjës sektori	1
- Specialist	1
- Punonjës shërbimi	11
11. Drejtoria e Financës	7
➤ Drejtor	1
➤ Sektori i Menaxhimit të Buxhetit dhe të Ardhurave	3
- Përgjegjës sektori	1
- Specialistë	2
➤ Sektori i Shërbimeve Financiare	3
- Përgjegjës sektori	1
- Specialistë	1
- Administrator i Vlerave Materiale	1
Gjithsej	48

Rektori dhe 2 zv. rektorët nuk janë përfshirë tek numri total i administratës së Universitetit, mbasi janë përfshirë tek numri i personelit akademik të fakultetit.

Raporti personel akademik/personel administrativ ne universitetin "Fan S. Noli", Korçë është rritur mbi normën 31 % që duhet të jetë për arsye të shtimit të numrit të personelit ndihmës akademik me karakter administrativ.

Në lidhje me këtë çështje theksojmë faktin se bazuar në kërkesat e ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 38, pika 1, germa ç, është senati akademik që harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit në të gjitha nivelet ku ky i fundit e miraton këtë numër në zbatim të kërkesave të nenit 49 të ligjit.

Në udhëzimin nr.27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë" janë përcaktuar strukturat e brendshme dhe varësitë përkatëse të tyre. Në pikën 15 të këtij udhëzimi përcaktohet se struktura akademike, ndihmës akademike me karakter akademik dhe ndihmës akademike me karakter administrativ, janë në varësi të rektorit. Ndërsa këto struktura në nivel njësie kryesore (Fakulteti), kanë varësi funksionale nga dekani.

Ka një propozim nga universiteti, nisur nga përcaktimet e mësipërme, që Bordi i Administrimit të jetë organi kompetent për të përcaktuar kategoritë, kriteret dhe procedurat e punësimit edhe në rastin e personelit ndihmës akademik me karakter administrativ

Universiteti ka përpiluar statutin, i cili është miratuar nga MASR me shkresën nr.56, datë 08.02.2018, gjithashtu ka përpiluar dhe rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore, rregullore e cila është miratuar me vendimin e senatit nr. 578, datë 02.10.2018.

Opinion

Sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon në përputhje me sistemet e vendosura për këtë qëllim. Struktura organizative e subjektit është hartuar në përputhje me legjislacionin, burimet njerëzore janë të afta për t'ju përgjigjur në çdo kohë realizimit të objektivave që ka Institucioni.

3. Auditim i sistemit të pagave (zbatimin e procedurave ligjore në llogaritjen dhe dhënien e pagave:

- janë zbatuar dispozitat ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave;
- sistemi i listë-pagesave është në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- janë zbatuar dispozitat ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

Janë zbatuar dispozitat ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave.

Sistemi i listë pagesave është në përputhje me legjislacionin në fuqi

Listë-prezencat, rishikohen, miratohen, përpunohen, dokumentohen dhe regjistrohen qartë.

Orët e punës së personelit, personat që largohen, pagat dhe ndalesat e pagave janë autorizuar siç duhet. Të gjitha pagesat janë bërë në kohë.

Pagesat janë regjistruar në vlerën e duhur.

Libri i pagave mbahet në rregull. Në të janë plotësuar pagat, shtesat mbi pagë, ndalesat për sigurime shoqërore dhe tatimin mbi pagë.

Nga mbledhja aritmetikore e listë pagesave rezulton se nuk ka gabime. Përmbledhësja e listë pagesës është në shumë të barabartë me shumën e urdhër shpenzimeve.

Përmbledhëse e liste pagesës në çdo rast ka firmën dhe vulën e degës së thesarit në rreth.

Listë pagesat në çdo rast janë të shoqëruara me listë prezencat dhe janë plotësuar sipas rregullave në fuqi.

Nga auditimi me zgjedhje në disa listë pagesa rezulton se janë llogaritur saktë ndalesat për sigurime shoqërore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi.

Opinion

Sistemi i kontrollit të brendshëm në këtë fushë funksionon drejtë. Kuadri rregullator në sistemin e pagave ka gjetur zbatim në mënyrë korrekte.

4. Auditim i sistemit për hartimin e zbatimit e buxhetit:

- zbatimi i ligjshmërisë për hartimin e zbatimit e buxhetit;
- zbatimi i procedurave ligjore me sistemin e thesarit;
- harmonizimi i përdorimit të fondeve nga granti dhe fondet nga të ardhurat e universitetit në funksion të realizimit të objektivave;

Bazuar në praktikat dokumentare dhe dokumentacionin vënë në dispozicion u evidentua sa më poshtë vijon :

Bordi i Administrimit i Universitetit "Fan S. Noli", i mbledhur në datën 08.01.2018, pasi shqyrtoi kërkesën e Rektorit të Universitetit për:

-miratimin e ndarjes së grantit buxhetor, alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2018;

-miratimin e përdorimit të të ardhurave të institucionit, parashikuar për vitin 2018;

-miratimin e Regjistrimit të Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2018;

-miratimin e detajomi të planit të Investimeve për vitin 2018; në zbatim të ligjit m.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika c dhe e, të ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 16, pika 2, ka vendosur

Miratimin e ndarjes së grantit buxhetor, alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2018 (bashkëngjitur, material përkatës),

Miratimin e përdorimit të të ardhurave të institucionit, parashikuar për vitin 2018.

Miratimin e Regjistrimit të Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2018.

Miratimin e detajimit të planit të investimeve për vitin 2018.

Detajimi i Grantit Buxhetor për vitin 2018								
Entit i Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kodi i Institucionit	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llog. Ekonomike	Kodi i Qarkut	Debiti
Shtesa								310,227,000
001	11	1011046	Univ "Fan S.Noli" Korçe	08	09450	6000000	1515	240,000,000
001	11	1011046	Univ "Fan S.Noli" Korçe	08	09450	6010000	1515	40,000,000
001	11	1011046	Univ "Fan S.Noli" Korçe	08	09450	6020000	1515	5,000,000
001	11	1011046	Univ "Fan S.Noli" Korçe	08	09450	6060000	1515	25,227,000
Pakësime								310,227,000
001	11	1011046	Univ "Fan S.Noli" Korçe	01	09450	6040000	1515	310,227,000

Ne ndarjen e mesiperme eshte parashikuar dhe 602, per pagesa honorare per anetaret e senatit dhe bordit, si dhe per shpenzime te tjera korente

Realizimi i buxhetit për vitin 2018

Kapitulli	Programi	Llog. Ekonomike	Output kod	Plan	Fakt	
					310,227,000	306,455,678
08	09450	6000000	91105AA	240,000,000	239,707,368	
08	09450	6010000	91105AA	40,000,000	39,989,008	
08	09450	6020000	91105AA	5,000,000	4,925,377	
08	09450	6060000	91105AB	25,227,000	21,833,925	

Bordi i Administrimit i Universitetit "Fan S. Noli", i mbledhur në datën 08.01.201, pasi shqyrtoi kërkesën e Rektorit të Universitetit për:

- miratimin e ndarjes së grantit buxhetor, alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2018;
- miratimin e përdorimit të të ardhurave të institucionit, parashikuar për vitin 2018;
- miratimin e Regjistrimit të Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2018;
- miratimin e detajimit të planit të Investimeve për vitin 2018; në zbatim të ligjit m.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika c dhe e, të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 16, pika 2, ka vendosur me vendimin nr.6, datë 08.01.2019:

Miratimin e ndarjes së grantit buxhetor nga buxheti i shtetit për vitin 2019, granti i mësimdhënies (paga dhe sigurime) dhe granti i mbështetjes studentor (bursa)

Detajimi i grantit buxhetor për vitin 2019

Kapitulli	Programi	Llog. Ekon	Output kod	Kodi i Qarkut	Debiti
Shtesa					310,543,533
,08	09450	6000000	91105AA	1515	250,583,843
,08	09450	6010000	91105AA	1515	41,500,000
,08	09450	6060000	91105AB	1515	18,459,690
Pakësime					310,543,533
,01	09450	6040000	91105AA	1515	292,083,843
,01	09450	6040000	91105AB	1515	18,459,690

Detajimi i Planit Buxhetor për vitin 2019 (shtese fondi për vitin 2019 - shkresë MASR, nr. 3496, datë 27.03.2019)

Kapitulli	Programi	Llog. Ekon.	Output kod	Kodi i Qarkut	Debiti
Shtesa					77,688,989
08	09450	6000000	91105AA	1515	22,000,000
08	09450	6020000	91105AA	1515	19,248,679
08	09450	6060000	91105AB	1515	36,440,310
Pakësimi					77,688,989
01	09450	6040000	91105AA	1515	41,248,679
01	09450	6040000	91105AB	1515	36,440,310

Realizimi i buxhetit janar – tetor 2019

Kapitulli	Programi	Llog. Ekonomike	Output kod	Plan	Fakt
388,232,522					320,620,153
08	09450	6000000	91105AA	272,583,843	233,244,544
08	09450	6010000	91105AA	41,500,000	34,495,407
08	09450	6020000	91105AA	19,248,679	9,207,202
08	09450	6060000	91105AB	54,900,000	43,673,000

Nr. i Gjetjes 2

Subjekti i Audituar	Drejtoria Ekonomike
Njësitëe interesuar	- Administratori - Drejtoria Ekonomike
Përmbledhja e bazës ligjore	- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 463, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa të vendimit nr.511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet buxhetore. - Udhëzimi i Ministrisë së Financës nr. 16, datë 20.07.2011 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.463 datë 16.06.2011.
Përshkrimi i gjetjes	Janë bërë pagesa për orë jashtë orarit pa marrë më parë autorizim nga Ministri i financave, kërkesë e udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011. Me urdhër shpenzimin nr.312, datë 18.1.2018 më shumë 417.811 lekë. Në këtë rast janë kryer pagesa për orë jashtë orarit për 14 punonjës, nga të cilët 5 janë punonjës të IT dhe 10 punonjës të sekretarisë mësimore. Puna që kanë kryer jashtë orarit është vlerësuar si kohë operationale dhe janë paguar për këtë qëllim. Për punonjësit e IT orët e punuara jashtë orarit duhet të kompensoheshin me ore ditë pushimi. Sipas pretendimeve të universitetit këto pagesa si për vitin 2018 dhe në vitin 2019 janë bërë vetëm për sekretaritë mësimor dhe punonjësit e IT në periudhën e regjistrimit, ndërsa për personelin e shërbimit dhe personelin administrativ këtë vit nuk janë bërë pagesa.
Konkluzioni	Kjo situatë ka ardhur për shkak të mos njohjes së kuadrit rregullator për pagesat e orëve jashtë orarit të kryera nga administrata e Institucionit

Vlerësimi i riskut	I mesëm
Rekomandimi	Të zbatohen aktet ligjore për përdorimin e fondeve buxhetore për pagesat e orëve jashtë orarit të kryera nga administrata e Institucionit
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	<i>Ky rekomandim është zbatuar. Ministri i Financës me shkresën nr. 21865/1, datë 12.12.2019 ka miratuar pagesën për orët jashtë orarit</i>
Statusi i rekomandimit	<i>Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar brenda dhjetorit 2019</i>

U Auditua dhe për shpenzimet që bëhen nga Universiteti për Zërin "Pagesë për roje private" dhe rezultoi:
-Ambientet dhe numri i posteve të rojeve private janë si më poshtë:

Lloji i Pronës	Emri i Pronës (Adresa)	Sip. Totale Ndërtesë / Truall (m ²)	Nr. i Vend rojeve
1.- Ndërtesë 4k	Godina e Fak. Ekonomisë	539	1 Vendroje me tre turne - 24 ore 1 Vendroje me nje turn - 8 ore (22:00 - 06:00)
2.- Ndërtesë 4K	Shtesë Godina e Fak. Ekonomisë	100	
3.- Ndërtesë 3K	Godina e Fak. Të Bujqësisë	471	
4.-Ndërtesë 3K	Godina e Fak. Edukimit dhe Filologjisë	1,115	
5.- Truall	Truall funksional i përbashkët mes fakulteteve	4,390	
Truall + Ndërtesë 4K	Godina e Dep. Infermierisë	258	1 Vendroje me tre turne - 24 ore
Truall + Ndërtesa	Godina e Fak. Shkencat e natyrës dhe Humane	1,222	1Vendroje me tre turne - 24 ore
Truall + Ndërtesë 4K	Godina e re e Rektoratit	319	1Vendroje me tre turne - 24 ore
Ndërtesë 1K + Sip Bujqësore	Ekonomia Didaktike Eksperimentale (Godina dhe toke bujqësore e mbjelle)	228,664	1Vendroje me tre turne - 24 ore

Siç shihet nga tabela pesë objektet e para janë brenda territorit të Universitetit, ndërsa godinat e tjera janë të shpërndara në qytetin e Korçës dhe detyrimisht duhet të kenë nga një post roje. Në llogari të koston së shpenzimeve për shërbimin e ruajtjes për vitin 2018 dhe 2019, na rezultojnë:

VITI	Numri i vend/rojeve	Pagesa per 1 v/roje dite	Pagesa per 5.3 v/roje dite	Pagesa per 1 v/roje muaj	Pagesa per 5.3 v/roje muaj	KOSTO VJETORE	kosto vjetore meTVSH
1	2	3	4	5	6	7	8
			=2*3	=3*30.41 dite	=4*30.41 dite	=6 * 12 muaj	=7 * 120%
2018	5.3	7990	42.347	242975.9	1,270,410	15,244,920	18,293,904
2019	5.3	8656	45876.8	263228.96	1,376,304	16,515,648	19,818,778

Llogaritja e fondit limit për vitin 2019 është bërë duke patur parasysh sa më poshtë:

SHËRBIMË TË SIGURIMIT E RUAJTJES VITI 2019 - MARRËVESHJE KUADËR			
LLOGARITJA E FONDIT LIMIT			
Të dhëna të përgjithshme sipas VKM nr.809 datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"			
Paga minimale	26,000	39,000	

Orë pune në muaj		174			
P. baze minimale orare		224.14			
Emertimi	Ore ne dite	Ore ne muaj	Shtesa mbi page/ore	Shtesa ne muaj per 1 vendroje me tre turne (4.98 roje)	Shtesa ne muaj per 1 punonjes ne lekë
Ore turni II (120%) 19:00 - 22:00	3	91.23	44.83	4,089.62	821.21
Ore turni III (150%) 22:00 - 06:00	8	243.28	112.07	27,264.14	5,474.73
Paga minimale					39,000.00
Paga me shtesa për 1 punonjës/muaj					45,295.94
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 16.7%					7,564.42
Paga gjithsej					52,860.36
Paga minimale per 1 vendroje me 3 turne (4.98 punonjës) në muaj					263,244.58
Paga minimale për 1 vendroje në ditë					8,656.51
Pagesa për 5.3 v/r në ditë					45,879.52
Pagesa për 381 ditë (12.53 muaj)					17,480,097.76
TVSH					3,496,019.55
TOTALI ME TVSH					20,976,117.31

Shuma e parashikuar si shpenzim për shërbimin e ruajtjes është rreth 4 % e buxhetit të universitetit U auditua dosja e procedurës së prokurimit dhe rezultoi:

- Urdhri i prokurimit nr.24, datë 17.01.2019.

Procedurë e hapur, marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12.53 muaj (381 ditë), me fond limit 17,480,097.76 lekë pa tvsh, fond limit për një vendroje/muaj – 263,244.58 lekë pa tvsh dhe fond limit për një vendroje/ditore - 8,656.51 lekë pa tvsh. Është paraqitur ankesa datë 26.01.2019, e operatorit ekonomik "GORA" shpk mbërritur dhe protokolluar në Universitetin "Fan S. Noli" me nr.194 prot., datë 30.01.2019. Është nxjerrë Urdhri nr.50, datë 30.01.2019 për pezullimin e procedurës, deri në shqyrtimin e plotë të kësaj ankese, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, me shkresën nr. 194/1 prot., datë 31.01.2019, "Kthim përgjigjeje ankesës së operatorit ekonomik "GORA" sh.p.k", i është kthyer përgjigje për ankesën këtij operatori. Ankesa nuk është pranuar, pasi është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar në ligj. Është nxjerrë Urdhri nr. 55, datë 31.01.2019, për heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit. Morën pjesë në tender tre operatorë ekonomikë. Është shpallur fitues operatori ekonomik "Alben 2 Security" shpk. U nënshkrua në bazë të marrëveshjes kuadër të nënshkruar nr. 497 prot., datë 13.03.2019, kontrata nr. 499 prot., datë 13.03.2019 me vlerën 20,976,046.39 lekë me tvsh (kohëzgjatja 381 ditë (12.53 muaj)).

Procedura vlerësohet se është realizuar sipas përcaktimeve ligjore në kuadrin rregullator të prokurimit publik.

Opinion

Sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon në përputhje me kuadrin rregullator, përjashtuar rastin e pagesave për orët jashtë orarit, gjë cila ka ardhur për shkak të mos njohjes së kuadrin rregullator për pagesat e orëve jashtë orarit të kryera nga administrata e Institucionit Fondet e vëna në dispozicion nga MASH-i përputhen me kërkesat e subjektit si dhe me projektbuxhetin e paraqitur nga vet institucioni. Përmirësimi i këtyre sistemeve bëhet i mundur me zbatimin e rekomandimeve që do të lejë grupi i auditimit.

5. Auditim i sistemit të prokurimeve të fondeve publike:

- zbatimi i procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike;
- vlerësimi i hartimit të nevojave konkrete për investime, mallra dhe shërbime;
- argumentimi dhe përlogaritja e fondit limit, të projekteve, mallrave dhe shërbimeve;
- vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në momentin e lidhjes së kontratës, zbatimit të saj dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve deri në inventarizimin dhe arkivimin e dosjes;
- blerjet, janë bërë sipas kërkesave nga personat e autorizuar;
- mallrat e blera janë pranuar, bërë hyrje, likuiduar dhe kontabilizuar sipas kriterëve ligjore;

Në mënyrë analitike procedurat e zhvilluara për prokurimet në periudhën e audituar i paraqesim më poshtë:

A.- Për vitin 2018

Nr	Objekti i prokurimit	Të dhëna rreth procedurës së prokurimit
1	"Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes"	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhri i prokurimit nr.23, datë 25.01.2018. Procedurë e hapur, marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 374 ditë, me fond limit 15 833 333 lekë pa tvsh dhe fond limit për një vëndroje/ditore 7990.6 lekë pa tvsh. Morën pjesë në tender dy operatorë ekonomikë. Është shpallur fitues operatori ekonomik "Alben 2 Security" shpk. U nënshkruan dy kontrata në bazë të marrëveshjes kuadër të nënshkruar me nr. 468 prot., datë 06.03.2018: kontrata nr. 470 prot., datë 06.03.2018 dhe kontrata nr. 2505 prot., datë 31.12.2018, përkatësisht me vlerat: 15 244 920 lekë me TVSH (kohëzgjatja 300 ditë) dhe 3,709,597.20 lekë me TVSH (kohëzgjatja 73 ditë).
2	"Materiale kancelarie, bojë fotokopjeje dhe bojë printeri"	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhri i prokurimit nr.264, datë 05.04.2018 Kërkesë për propozim. Fondi limit 3 333 331 lekë pa tvsh, Loti I – "Materiale kancelarie" me fond limit: 1.105.046 lekë pa tvsh dhe Loti II – "Bojë fotokopje dhe bojë printeri" me fond limit: 2.228.285 lekë pa tvsh. Ka patur një ankesë, datë 17.04.2018, nga operatori ekonomik "ADASTRA" shpk në lidhje me dokumentet e tenderit, për lotin II. Është nxjerrë Urdhri nr.292, datë 19.04.2018 për pezullimin e lotit II, deri në shqyrtimin e plotë të kësaj ankese, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, me shkresën nr. 808/1 prot., datë 20.04.2018, "Kthim përgjigjeje ankesës datë 17.04.2018", i është kthyer përgjigje për ankesën, operatorit ekonomik "ADASTRA" shpk. Ankesa nuk është pranuar, pasi është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar në ligj. Është nxjerrë Urdhri nr. 297, datë 20.04.2018, për heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit. Kanë marrë pjesë në tender tre operatorë ekonomikë në lotin I dhe gjashtë operatorë ekonomikë në lotin II. Është paraqitur një ankesë në lidhje me

valerësimin në lotin II datë 30.04.2018, nga operatori ekonomik "Infosoft Office" shpk. Është nxjerrë Urdhri nr.327, datë 02.05.2018 për pezullimin e lotit II, deri në shqyrtimin e plotë të kësaj ankese, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, me shkresën nr. 953/1 prot., datë 08.05.2018, "Dërgim i përgjigjes në lidhje me ankesën datë 30.04.2018", i është kthyer përgjigje për ankesën, operatorit ekonomik "Infosoft Office" shpk. Ankesa nuk është pranuar. Operatori ekonomik "Infosoft Office" shpk është ankuar më tej në Komisionin e Prokurimit Publik. Me Vendimin nr. 431/1 prot., datë 26.06.2018, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur për mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik "Infosoft Office" shpk. Është nxjerrë Urdhri nr. 432, datë 29.06.2018, për heqjen e pezullimit të lotit II. Është shpallur fitues për lotin I, operatori ekonomik Infosoft Office sh.p.k me të cilin është lidhur kontrata nr. 1073 prot., datë 22.05.2018 me vlerën 1 049 660,4 lekë me TVSH. Ka paraqitur dokumentacionin operatori ekonomik fitues i lotit II, Adenis Kastrati, i cili nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës për të vijuar më tej me lidhjen e saj, me gjithë lajmërimin e dërguar në adresë të tij nga autoriteti kontraktor me shkresën nr.1360 prot., datë 10.07.2018 "Ftesë për lidhjen e kontratës". Duke qenë se diferenca e vlerës së ofertës së renditur në vend të parë me atë të renditur në vend të dytë tejkalonte 2 % të vlerës së fondit limit (përcaktuar në neni 58, të LPP-së), nuk mund të procedohej me dërgimin e njoftimit të fituesit operatorit ekonomik të renditur në vend të dytë. Për këtë arsye është nxjerrë nga administratori i universitetit, Vendimi nr. 465, datë 17.07.2018 për anulimin e lotit II "Bojë fotokopje dhe bojë printeri". Njoftimi i anulimit të lotit II, është botuar në BNJP nr.29, datë 23.07.2018.

- Urdhri i prokurimit nr.497, datë 27.07.2018.

3 **"Bojë
fotokopjeje
dhe bojë
printeri"**

Kërkesë për propozim. Fondi limit 2.228.285 lekë pa TVSH. U paraqitën dy kërkesa për sqarim, përkatësisht nga operatorët ekonomikë "Mond Office" sh.p.k dërguar në SPE në datën 09.08.2018 dhe "Citrus" sh.p.k dërguar në SPE në datën 13.08.2018, të cilave u kthye përgjigje. Ka patur një ankesë, nr.1539 prot., datë 13.08.2018, nga operatori ekonomik "ADASTRA" shpk në lidhje me dokumentet e tenderit. Është nxjerrë Urdhri nr.513, datë 13.08.2018 për pezullimin e procedurës, deri në shqyrtimin e plotë të kësaj ankese, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, me shkresën nr. 808/1 prot., datë 20.04.2018, "Kthim përgjigjeje ankesës datë 17.04.2018", i është kthyer përgjigje për ankesën, operatorit ekonomik "ADASTRA" shpk. Ankesa nuk është pranuar. Është nxjerrë Urdhri nr.515, datë 24.08.2018, për heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit. Morën pjesë në tender tre operatorë ekonomikë. Është lidhur kontrata nr. 1672 prot., datë 19.09.2018 me OE fitues Adenis Kastrati, person fizik, me vlerën 2 376 000 lekë me TVSH.

- Urdhri i prokurimit nr.369, datë 22.05.2018.

4

“Blerje pajisje kompjuterike”

Kërkesë për propozim. Fondi limit 4.166.667 lekë pa tvsh. Morën pjesë në tender tre operatorë ekonomikë. Është shpallur fitues operatori ekonomik Atom sh.p.k dhe është nënshkruar kontrata nr. 1314 prot., datë 03.07.2018 me vlerën 4 348 800 lekë me tvsh.
- Urdhri i prokurimit nr.300, datë 20.04.2018.

5 **“Lëndë djegëse, karburant”**

Kërkesë për propozim, Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj. Fondi limit 7,833,332.42 lekë pa tvsh, Loti I - “Lëndë djegëse për kaldajat (Naftë D1)” me fond limit për 12 muaj: 6,665,618.08 lekë pa tvsh dhe Loti II - “Naftë për automjetet (Naftë D1) me fond limit për 12 muaj: 1,167,714.34 lekë pa tvsh. Morën pjesë në tender tre operatorë ekonomikë në lotin I dhe dy operatorë ekonomikë në lotin II. Është shpallur fitues i lotit I, operatori ekonomik RESULI – ER sh.a, i cili në datën 28.05.2018 ka njoftuar tërheqjen nga procedura e prokurimit. U lidhën dy kontrata në bazë të marrëveshjes kuadër të nënshkruar me nr.1185 prot., datë 05.06.2018, me OE të renditur në vendin e dytë “AROIL COMPANY” sh.p.k me marzh fitimi 4%: kontrata nr. 1193 prot., datë 06.06.2018 dhe kontrata nr. 2503 prot., datë 31.12.2018. Është shpallur fitues i lotit II, operatori ekonomik “AROIL COMPANY” sh.p.k. U lidhën dy kontrata në bazë të marrëveshjes kuadër të nënshkruar me nr.1150 prot., datë 31.05.2018, me marzh fitimi 4%: kontrata nr. 1157 prot., datë 31.05.2018 dhe kontrata nr. 2504 prot., datë 31.12.2018.

B.- Për periudhën 1 janar – 30 nëntor 2019

Nr Objekti i prokurimit

Të dhëna rreth procedurës së prokurimit

1 **“Shërbime të sigurimit e ruajtjes”**

- Urdhri i prokurimit nr.24, datë 17.01.2019.
Procedurë e hapur, marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12.53 muaj (381 ditë), me fond limit 17,480,097.76 lekë pa tvsh, fond limit për një vëndroje/muaj – 263,244.58 lekë pa tvsh dhe fond limit për një vëndroje/ditore - 8,656.51 lekë pa tvsh. Është paraqitur ankesa datë 26.01.2019, e operatorit ekonomik “GORA” shpk mbërritur dhe protokolluar në Universitetin “Fan S. Noli” me nr.194 prot., datë 30.01.2019. Është nxjerrë Urdhri nr.50, datë 30.01.2019 për pezullimin e procedurës, deri në shqyrtimin e plotë të kësaj ankesë, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, me shkresën nr. 194/1 prot., datë 31.01.2019, “Kthim përgjigjeje ankesës së operatorit ekonomik “GORA” sh.p.k”, i është kthyer përgjigjeje për ankesën këtij operatori. Ankesa nuk është pranuar, pasi është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar në ligj. Është nxjerrë Urdhri nr. 55, datë 31.01.2019, për heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit. Morën pjesë në tender tre operatorë ekonomikë. Është shpallur fitues operatori ekonomik “Alben 2 Security” shpk. U nënshkrua në bazë të marrëveshjes kuadër të nënshkruar nr. 497 prot., datë 13.03.2019, kontrata nr. 499 prot., datë 13.03.2019 me vlerën 20,976,046.39 lekë me tvsh (kohëzgjatja 381 ditë (12.53 muaj)).

- 2 **“Materiale kancelarie, bojë fotokopje & printeri”** - Urdhri i prokurimit nr.106, datë 26.02.2019. Kërkesë për propozim. Fondi limit 4,166,667.00 lekë pa tvsh, Loti I “Materiale kancelarie” me fond limit: 1,237,333.70 lekë pa tvsh dhe Loti II “Bojë fotokopje & printeri” me fond limit: 2,929,333.30 lekë pa tvsh. Është paraqitur kërkesë për sqarim, nga operatori ekonomik MondOffice shpk dërguar në SPE në datën 05.03.2019, si dhe në datën 12.03.2019 nga operatori ekonomik 4K Distribution shpk, të cilave iu kthye përgjigje. Ka patur një ankesë, mbërritur dhe protokolluar në Universitetin “Fan S. Noli” me nr.458 prot., datë 08.03.2019, nga operatori ekonomik “ADASTRA” shpk në lidhje me dokumentet e tenderit, për lotin II. Është nxjerrë Urdhri nr.133, datë 08.03.2019 për pezullimin e lotit II, deri në shqyrtimin e plotë të kësaj ankese, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, me shkresën nr. 458/1 prot., datë 08.03.2019, “Kthim përgjigjeje ankesës së operatorit ekonomik “ADASTRA” shpk, i është kthyer përgjigje për ankesën, këtij operatori. Ankesa nuk është pranuar, pasi është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar në ligj. Është nxjerrë Urdhri nr. 135, datë 08.03.2019, për heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit. Kanë marrë pjesë në tender dy operatorë ekonomikë në lotin I dhe gjashtë operatorë ekonomikë në lotin II. Është shpallur fitues në lotin I OE Ilirjan Postoli P.F, me të cilin u lidh kontrata nr. 681 prot., datë 09.04.2019 me vlerën 923 580 lekë me TVSH. Është shpallur fitues në lotin II, OE ERISONY COMPANY shpk, me të cilin u lidh kontrata nr. 666 prot., datë 05.04.2019 me vlerën 2 738 400 lekë me TVSH.
- 3 **“Mat. Pastrim-dezinfektimi, ndriçimi, lyerje etj.”** - Urdhri i prokurimit nr.108, datë 26.02.2019. Kërkesë për propozim. Fondi limit 1,666,667 lekë pa TVSH: Loti I “Mat.pastrim-dizifektimi (Detergjente dhe materiale pastrimi)” 445,400 lekë, Loti II “Materiale ndriçimi (materiale elektrike, hidraulike etj.)” 812,267 lekë dhe Loti III “ Materiale lyerje” 409,000 lekë. Morën pjesë në tender: në lotin I - 6 operatorë ekonomikë, në lotin II - 6 operatorë ekonomikë dhe në lotin III – 9 operatorë ekonomikë. U paraqit një ankesë (datë 25.03.2019) nga operatori ekonomik Naim Hysi, person fizik, në lidhje me vlerësimin në lotin II. Është nxjerrë Urdhri nr.166, datë 29.03.2019 për pezullimin e lotit II, deri në shqyrtimin e plotë të kësaj ankese, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, me shkresën nr. 580/1 prot., datë 02.04.2019, i është kthyer përgjigje për ankesën, këtij operatori. Ankesa është pranuar, dhe me shkresën nr. 603/1 prot., datë 02.04.2019, administratori i institucionit i ka përcjellë KVO-së për zbatim, vendimin të tre punonjësve të ngarkuar me Urdhrin nr. 167, date 29.03.2019 për shqyrtimin dhe dhënien e një vendimi për ankesën e operatorit ekonomik “Naim Hysi”, person fizik. Është nxjerrë Urdhri nr. 175, datë 02.04.2019, për heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit. Është bërë rivlerësimi i ofertave nga ana e KVO-së. Është lidhur kontrata nr. 671 prot., datë 08.04.2019 me OE fitues të lotit I, “4 S” sh.p.k në vlerën 432 000 lekë me TVSH. Është lidhur kontrata nr. 750 prot., datë 17.04.2019 me OE fitues të lotit II, Naim Hysi, person fizik në vlerën 909,379.20 lekë me TVSH. Është lidhur kontrata nr. 680 prot., datë

- 09.04.2019 me OE fitues të lotit III, Halil Dervishi, person fizik, në vlerën 292 500 lekë me TVSH.
- 4 **“Blerje pajisje kompjuterike dhe audiovizuale”** - Urdhri i prokurimit nr.315, date 13.06.2019.
Kërkesë për propozim. Fondi limit 2,083,327.70 lekë pa tvsh. Morën pjesë në tender katër operatorë ekonomikë. Është shpallur fitues operatori ekonomik PC STORE sh.p.k dhe është nënshkruar kontrata nr. 1305 prot., datë 23.07.2019 me vlerën 2 215 080 lekë me tvsh.
- 5 **“Lëndë djegëse, karburant”** - Urdhri i prokurimit nr.387, datë 17.07.2019.
Kërkesë për propozim, Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj. Fondi limit 7,833,147.19 lekë lekë pa tvsh, Loti I - “Lëndë djegëse për kaldajat (Naftë D1)” me fond limit për 12 muaj: 7,409,899.19 lekë pa tvsh dhe Loti II - “Naftë për automjetet (Naftë D1) me fond limit për 12 muaj: 423,248.00 lekë pa tvsh. Morën pjesë në tender katër operatorë ekonomikë në lotin I dhe dy operatorë ekonomikë në lotin II. Është shpallur fitues i lotit II, “AROil COMPANY” sh.p.k, me të cilin, në bazë të marrëveshjes kuadër të nënshkruar nr. 1651 prot., date 03.10.2019, u lidh kontrata nr. 1667 prot., datë 04.10.2019 me marzh fitimi 4%. Është paraqitur ankesa datë 17.09.2019 e OE RESULI-ER sha në lidhje me vlerësimin në lotin I. Është nxjerrë Urdhri nr.453, datë 19.09.2019 për pezullimin e lotit I, deri në shqyrtimin e plotë të kësaj ankese, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, me shkresën nr. 1502/2 prot., datë 25.09.2019, i është kthyer përgjigje për ankesën, këtij operatori. Ankesa nuk është pranuar. OE ankimes ka paraqitur ankim në Komisionin e Prokurimit Publik. Autoriteti Kontraktor ka dërguar pranë KPP-së shkresën nr. 1689/1 prot., date 08.10.2019, “Informacion në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik RESULI-ER sha lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me objekt: “Lëndë djegëse, karburant”, Loti I - “Lëndë djegëse për kaldajat (Naftë D1)”. Me shkresën nr. 1542/3 prot., date 24.10.2019, KPP ka njoftuar AK, OE ankimes, si dhe APP-në, se për arsye të ligjshme, për shkak të fluksit të madh të ankesave dhe ngarkesës si rrjedhojë e problematikave të tyre, nuk mund të dalë me një vendim përfundimtar brenda afateve të përcaktuara nga ligji. Aktualisht procedura për lotin I vazhdon të jetë e pezulluar në pritje të vendimit të KPP-së.

U audituan me zgjedhje disa praktika për blerjet me vlerë të vogël, nga ku rezultoi se janë zbatuar në mënyrë korrekte kërkesat e kuadrit rregullator në këtë fushë.

Për vitin 2018 janë realizuar procedura sipas regjistrit, pjesë e dosjes së auditimit.

Vlera totale e realizimeve (Pa tvsh) për vitin 2018 për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël është 8,813,708 në 75 raste të përdorimit të kësaj procedurë

Për periudhën janar – nëntor 2019 janë realizuar 58 procedura prokurimi me vlerë të vogël

Vlera totale e realizimeve (Pa tvsh) për vitin 2019 për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël është 6.152.877 në 58 raste të përdorimit të kësaj procedurë.

Opinion

Sistemi i kontrollit të brendshëm në fushën e prokurimeve me fondet e grantit dhe të ardhurat e Universitetit funksionon në përputhje me kuadrin rregullator në fushën e prokurimeve të fondeve publike.

Fondet e përdorura për investime dhe blerje për garantimin e funksionimit normal të aktivitetit të Universitetit janë përdorur me frytshmëri dhe efektivitet.

6. Auditim i sistemit të kontabilitetit financiar:

- organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit;
- auditim i veprimeve kontabile të regjistruar në ditarë sipas shpenzimeve të konstatuara;
- mbajtja dhe plotësimi i dokumentacionit financiar e kontabël, sipas procedurave ligjore;
- mbi ligjshmërinë e dokumenteve justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike;
- të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat janë regjistruar me saktësi dhe janë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret që drejtojnë veprimtarinë e subjektit;

Ne kemi audituar bilancin kontabël në Universitetin "Fan S.Noli", Korçë për ushtrimin e mbyllur dhe pasqyrat përkatëse të të ardhurave dhe të fluksit të parasë për datën, 31.12.2018

Të gjitha regjistrimet janë të mbështetur mbi dokumente justifikues baze dhe që ju referohen operacioneve ekonomike të ndodhura dhe të mara në kontabilitet gjatë periudhës.

U bë verifikimi i shumave të bilancit të çeljes me ato të mbylljes të ushtrimit paraardhës dhe nuk pati devijime.

U bë vlerësimi i elementëve ekstra kontabël si inventarët, skedat e aktiveve të qëndrueshme, skeda e stokut si dhe analizat e llogarive sintetike.

Në fund të vitit ushtrimorë 2018 është bërë inventarizimi i elementeve pasuror te subjektit.

Nga krahasimi i vlerës së inventarit kontabël ne magazine dhe në përdorim me atë të pasqyruar në bilancin e mbyllur në datën 31.12.2018 për aktivet e qëndrueshme rezultoi:

Të ardhurat dhe shpenzimet e regjistruara janë klasifikuar dhe u është vënë kodi i saktë në regjistrimet kontabile.

Vlerësojmë se ka një sistem të mirë përcaktuar në evidencën kontabile dhe të raportimit financiar.

Angazhimi i drejtimit për të projektuar dhe mbajtur sisteme të besueshme të kontabilitetit vlerësohet optimal.

Stafi është njohur dhe trajnuar me kodin e etikës të organizatës dhe është ndjekur në vazhdimësi zbatimin e tij. Periodikisht vlerësohet performanca e stafit kundrejt objektivave.

Procesi i rekrutimit bëhet sipas kriterëve të aftësisë, kualifikimit dhe eksperiencës së nevojshme.

Drejtimi ka vlerësuar drejtë përdorimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe specifikisht përdorimin e sistemeve kompjuterike financiare.

Për arsye të kohës së kufizuar dhe numrit të vogël të grupit të auditit (2 auditues) nuk u bë një analizë e thelluar e treguesve të bilancit.

Kjo analizë është bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe nga grupi i auditimit është arritur në këto konkluzione:

Mbyllja e bilancit është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi dhe plotësimi i tij është bërë llogaritë dhe shumat përkatëse. Veprimet janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, bilanci kontabël si dhe pasqyrat financiare situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga UFSNK, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit, të cilat janë konfirmuar me vulosjen e tyre, brenda datës 28 shkurt të vitit pasardhës sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financës

Opinion

Evidentohet se sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon në përputhje me kuadrin rregullator për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e standardeve dhe rregullave kontabël, planit kontabël publik të institucioneve shtetërore qendrore.

Veprimet dhe transaksionet janë regjistruar mbi bazën e dokumenteve justifikuese, që mbështesin rregjistrimet kontabile si në mënyrë kronologjike, ashtu dhe sistematike, konform përcaktimeve të kuadrit rregullator Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet.

Mbajtja e kontabilitetit dhe hartimit të bilanceve kontabël vlerësohet e saktë dhe në përputhje ligjore të veprimeve ekonomike dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare.

7. Auditim i sistemit për menaxhimin e aktiveve:

- hartimi i gjurmëve specifike të auditit, të nevojshme për menaxhimin e aktiveve që disponojnë;
- menaxhimin e aktiveve sipas përgjegjësisë;
- inventarizimin fizik të aktiveve;
- marrjen në dorëzim të aktiveve;
- vlerësimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve;

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm i kontrollit i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë një vjeçare, si dhe përdorimin me eficientë të tyre. Inventarizimi kryhet sipas procedurave të miratuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"

Me urdhrin nr.146, datë 15.03.2019 lëshuar nga administratore Enshemvera Zake është urdhëruar që të kryhet inventarizimi i plotë i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra në ambientet e universitetit për vitin 2018 deri në datën 08.04.2019, me qëllim vlerësimin e saktësisë dhe cilësisë së gjendjes fizike të aktiveve.

Inventarizimi i plotë i aktiveve është bërë bazuar në të dhënat e regjistrave kontabël të aktiveve të universitetit.

Janë ngritur komisione për çdo fakultet dhe komisioni për gjithë universitetin

Komisioni i inventarizimit ka përpiluar një relacion, datë 08.04.2019 lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e dëmtimeve apo të gjendjes funksionale të konstatuara, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Me urdhrin nr.244, datë 24.04.2019 të Administratores është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të propozuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit deri në datën 06.05.2019

Komisioni i vlerësimit ka hartuar relacionin për vlerësimin e aktiveve të propozuara për nxjerrje nga përdorimi, ku sqarohen arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve është miratuar dhe nga Bordi i Administrimit.

Me urdhrin nr.255, datë 06.05.2019 është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara si të tilla.

Në përfundim të procesit është përpiluar procesverbali datë 23.05.2019 rezulton se janë nxjerrë jashtë përdorimit dhe janë asgjësuar me "Thyer e e groposje" dhe "Djegur" aktivet:

a.- Në rektorat:

- Llogaria 32	31 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	zero lekë
- Llogaria 213	1 artikull me vlerë të mbetur pas amortizimit	9.098 lekë
- Llogaria 214	16 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	85.615 lekë
- Llogaria 218	12 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	69.674 lekë
- Diploma të dëmtuara	93 copë me vlerë të mbetur pas amortizimit	zero lekë

b.-Në fakultetin e Bujqësisë:

- Llogaria 32	14 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	zero lekë
- Llogaria 214	16 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	34.946 lekë

- Llogaria 218	7 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	58.321 lekë
b.-Në fakultetin Ekonomik:		
- Llogaria 32	7 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	zero lekë
- Llogaria 214	2 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	8.539 lekë
- Llogaria 218	1 artikull me vlerë të mbetur pas amortizimit	13.882 lekë
c.- Në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë:		
- Llogaria 32	10 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	zero lekë
- Llogaria 213	2 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	10.918 lekë
- Llogaria 214	1 artikull me vlerë të mbetur pas amortizimit	20.756 lekë
- Llogaria 218	3 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	15.461 lekë
b.-Në fakultetin e Shkencave Humane:		
- Llogaria 32	1 artikull me vlerë të mbetur pas amortizimit	zero lekë
- Llogaria 214	8 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	34.192 lekë
- Llogaria 218	7 artikuj me vlerë të mbetur pas amortizimit	66.200 lekë

Nga auditimi i veprimeve të magazinës për periudhën, rezultoi se:

Të gjithë artikujt e blerë nga subjektet e ndryshme, dokumentoheshin me fletë hyrje;

Fletë hyrjet dhe fletë daljet ruanin radhën e tyre kronologjike dhe numrin përkatës;

Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit ishte i bazuar në dokumentet origjinal;

Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente autorizues, vërtetues dhe dokumentet e kontabilitetit .

Opinion

Evidentohet se sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon në përputhje me bazën ligjore në këtë fushë. Vërtetohet saktësia dhe rregullariteti i dokumentimit të veprimeve të kryera me anë të magazinës, metodat e mbajtjes dhe të vlerësimit të inventarëve në kontabilitet si dhe masat e marra për ruajtjen e aseteve.

8. Auditim i sistemit mbi përdorimin e fondeve për bursat:

- zbatimi i kriterëve për dhënien e bursave për studentët në përputhshmëri me VKM-në, për bursat;
- ngritja e komisioneve për shqyrtimin e dokumentacionit për përfitimin e bursave;
- auditim i dokumentacionit të bursave për studentët e viteve të para të ardhura nga pushteti lokal;
- auditim i listë-pagesave për përfitimin e bursave nga studentët;

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimet e Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" që dalin për çdo vit dhe në zbatim të akteve ligjore që dolën mbas protestave të studenteve "Paketa Studenti, rezulton se studentët kanë përfituar si më poshtë:

Pasqyra e shpërndarjes së numrit të bursave për vitin akademik 2018-2019

Pasqyra e shpërndarjes së numrit të bursave për vitin akademik 2018-2019

Nr.	Vendime te bordi	Vendime te komisionit	Baza ligjore	Viti			mesatare	Gjithesëj
				I;II;III.	II	III		
1	Vend nr. 775 dt. 26.12.2018	P-V nr.1 dt. 20.12.2018	VKM nr. 903 me ndryshime		104	112		216
	Vend nr. 775 dt. 26.12.2018	P-V nr.1 dt. 20.12.2018	Student me mesatare				46	46
2	Vend nr. 64 dt.04.02.2019	Proces-verbal komisioni	Student me mesatare				27	27
	Vend nr. 64 dt.04.02.2019	Proces-verbal komisioni	VKM nr. 903 me ndryshime		45	35		80

3	Vendime Këshilli Bashkiak			206					206
4	Vend nr.113 dt.26.02.2019	Proces-verbal komisioni	VKM 29/01/2019	34					34
	Shuma			240	149	147	73		609

Për vitin 2019 janë paguar bursa:

Emertimi	Nr.	Paguar ne vitin 2019							TOTALI	
		Studenteve	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik		Korrik
Studente te shkëlqyer dhe me mesatare 9-10	73	730000	730000	1330750	730000	730000	730000	730000	365000	5345750
Sipas V.K.M. nr.903 dt.21.12.2016 ndryshuar	296	2880000	4036875	3023375	2960000	2960000	2960000	2960000	1480000	20300250
Sipas Vendimit nr.113 dt.26.02.2019	34			1700250	340000	340000	340000	340000	170000	2890250
Me vendime te Keshillave Bashkiake	206		5809375	2077875	2092250	2040000	2092250	1025000		15136750
0	609	3610000	10576250	8.132.250	6.122.250	6.070.000	6.122.250	3.040.000		43.673.000

Në kuadër të zbatimit të "Paketës studentë" kanë përfutur përveç bursa sa më lartë dhe nga mos pagesa e tarifës së shkollimit, sa më poshtë:

Nr.	Kthimi i tarifave	Gjithsej studente qe përfitojnë	Nr. Studenteve qe ju është kthyer tarifa.	Vlera e kthyer ne leke	Nuk kane sjelle Nr. Lloga
1	Cikli pare	139	127	1350000	12
2	Master	51	42	630000	9
	Shuma	190	169	1.980.000	21

9.- Auditim i sistemit mbi krijimin dhe përdorimin e të ardhurave:

- burimet e krijimit të të ardhurave;
- përdorimi i të ardhurave nga institucioni;
- zbatimi i akteve ligjore e nënligjore për tarifat e regjistrimit dhe të shkollimit;

Të ardhurat dytësore grumbullohen vetëm me bankë në zbatim të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar,

Drejtoria ekonomike që mbulon këtë aktivitet për çdo rast emeton formularin për arkëtim, që ju shpërndahet studentëve në mjediset e saj. Për raste pagesash të përgjithshme (tarifa regjistrimit në universitet, kreditet që paguajnë mësuesit që trajnohen etje.) këto formular jepen online.

Për regjistrimin e të ardhurave të konstatuara nga tarifat e shkollimit dhe evidentimin e pagesave të tyre, Drejtoria ekonomike ka hartuar një program kompjuterik dhe kryen regjistrimin për çdo rast të Ma që paraqet studenti në mjediset e kësaj zyre. Janë printuar pagesat për çdo datë duke i lidhur mandatet e bankave.

Kjo drejtori me specialistët që mbulojnë këtë proces, nxjerr raportet për studentët që nuk kanë kryer pagesat në fund të çdo semestri (para sezonit të provimeve) dhe nëpërmjet Administratorit ju përcillen Fakulteteve për të marrë masa shtrënguese nga personeli i fakulteteve për kryerjen e pagesave nga studentët debitor.

Krijimi i të ardhurave gjatë vitit 2018:

Nr	Art	Emertimi i te ardhurave	Te ardhura	Buxhet 10 %	Universiteti
1	7110103	Tarife per regjistrimin ne arsimin e larte	3,092,105		3,092,105
2	7110109	Tarifa e shkollimit	97,780,436		97,780,436
3	7207010	Sponsorizime nga organizata	8,975,382		8,975,382
4	7207012	Sponsorizime	500,000		500,000
5	7111003	Te ardhura te tjera	203,830		203,830
6	7109600	qira klubi e te tjera	615,694	61,569.40	554,125
7	7111099	te tjera te ardhura sekondare (Debitore)	622,372		622,372
8	7113001	Shitja e produkteve bujqesore dhe pyjore	694,760		694,760
9	7113099	Te tjera nga shitja e te ardhur dhe sherbimeve	3,579,470		3,579,470
Totali			116,064,049		116,002,480

janë derdhur në Buxhet 61.569 lekë (10 % e të ardhurave nga qiratë).
Fondet e krijuara nga të ardhurat e vitit 2018, janë shpenzuar si më poshtë

Shpenzime nga te ardhurat			Në lekë
1	600	Pagat (pedagog te jashtem, oret mbi ngarkese etje)	36,737,625
2	601	Sigurmet shoqer. Shendet.	0
3	602	Shpenzime te pergjitheshme materiale dhe operative	46,455,476
4	606	Transferta per buxhetet familjare	356,903
5	230	Studim projektim	
6	231	Investime	45,031,983
7	230	Kerkim shkencor	172,000
8	231	Kerkim shkencor	596,311
TOTALI I SHPENZIMEVE			129,350,297
	4662314	Garanci te vitit te trasheguara	

Krijimi i të ardhurave gjate vitit 2019

Nr	Art	Emertimi i te ardhurave	Te ardhura	Universiteti
1	7110103	Tarife per regjistrimin ne arsimin e larte	941,200	941,200
2	7110109	Tarifa e shkollimit	57,109,160	57,109,160
3	7207010	Sponsorizime nga organizata	53,720	53,720
4	7211100	Grante nga Organizata nderkombetare	3,632,361	3,632,361
5	7110110	Tarifa nga konkurset	180,000	180,000
6	7109600	qira klubi e te tjera	468,560	421,704
7	7111099	te tjera te ardhura sekondare (Debitore)	179,700	179,700
8	7113001	Shitja e produkteve bujqesore dhe pyjore	539,000	539,000
9	7113099	Te tjera nga shitja e te ardhurave dhe sherbimeve	2,485,200	2,485,200
Totali			65,588,901	65,542,045

janë derdhur në Buxhet 46.856 lekë (10 % e të ardhurave nga qiratë).

Fondet e krijuara nga të ardhurat e vitit 2019, janë shpenzuar si më poshtë:

Shpenzime nga të ardhurat			Ne lekë
1	600	Pagat (pedagog të jashtëm, orët mbi ngarkesë etje)	5,711,836
2	601	Sigurimet shoqer. Shendet.	-
3	602	Shpenzime të përgjithshme materiale dhe operative	35,332,774
4	606	Transferta për buxhetet familjare	20,000
5	230	Studim projektim	184,194
6	231	Investime	3,843,980
7	230	Kërkim shkencor	605,217
8	231	Kërkim shkencor	24,000
TOTALI I SHPENZIMEVE			45,722,001
	4662314	Garanci të vitit të trashëguara	3,113,819.89

Opinion

Evidentohet se sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon në përputhje me kuadrin rregullator.

10.- Auditim i sistemit të ngarkesave mësimore:

- planifikimi;
- realizimi;
- mbingarkesat (zbatimi i procedurave)

Në zbatim të kërkesave të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë" Rektori i universitetit ka nxjerrë një udhëzim të brendshëm për realizimin e normës së ngarkesës dhe orëve mbi normën e ngarkesës.

Në zbatim të këtij udhëzimi evidencat për plotësimin e orëve të mësimit të firmosura nga pedagogu u lëndës, përgjegjësi i departamentit dhe dekani janë dorëzuar në fund të semestrit dhe në ndonjë rast në fund të vitit akademik, pas përfundimit të programit lëndor të disiplinës.

Është bërë rakordimi i evidencave të paraqitura me planin mësimor të miratuar nga Senati Akademik dhe pas këtij rakordimi i është dërguar Drejtorisë Ekonomike.

Të dhënat për realizimin e normës për pedagogët e brendshëm dhe realizimi i orëve për pedagogët e jashtëm janë sipas pasqyrave në dosje.

Pagesa e orëve mbi normën e ngarkesës dhe për pedagogët e jashtëm është bërë nga të ardhurat e universitetit.

Për realizimin e orëve mësimore dhe pagesat për orët mbi normë për vitin akademik 2017-2018, u përpilua pasqyra, pjesë e dosjes së auditimit.

Nr. i Gjetjes 3	
Subjekti i Audituar	- Drejtoria e Kurrikulave, Sig. Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor
Njësitë/ subjektet e	- Administratori - Drejtoria Ekonomike - Drejtoria e Kurrikulave, Sig. Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor

interesuara nga gjetja	
Përmbledhja e bazës ligjore	<p>- Ligji nr.80 Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencorë në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik të institucioneve Publike të Arsimit të Lartë".</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".</p>
Përshkrimi i gjetjes	<p>Janë bërë pagesa për orët mbi normën e ngarkesës në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik të institucioneve Publike të Arsimit të Lartë.</p> <p>Pagesat janë bërë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Urdhër shpenzimit nr.235, dhe 236, datë 03.09.2018 ne shumën 35.116.894 lekë. <p>Pagesat janë bërë sipas vendimeve të organeve kolegjiale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendim i Senatit Akademik nr.32, datë 05.10.2017 - Vendim i Bordit të Administrimit nr.20, datë 12.10.2017. <p>Sipas këtyre vendimeve organet kolegjiale kanë miratuar pagesën e orëve mësimore mbi normën e ngarkesës deri në 200 orë. Sipas të dhënave në pasqyrën (Pjesë e dosjes së auditimit) rezulton se janë paguar mbi 30 % të normës së ngarkesës 16.504 orë me një efekt financiar 15.750.114 lekë.</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 pagesën për orët mbi normën e ngarkesës e rregullon Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".</p> <p>Sipas pikës II, 1paragrafi i trete thuhet që orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200 orë, ndërsa në pikën III, 2 "Dispozita të fundit thuhet "Personeli akademik i cili angazhohet në veprimtaritë e parashikuara në pikën 12 (Elementët e veprimtarive jashtë auditorit në ndihmë të procesit mësimor në IAL-të publike), Paguhen për ngarkesën e parashikuar si orë suplementare. Në këtë rast udhëzimi nuk e nxjer qartë së sa orë do të paguhen si ore suplementar ne këtë rast kur pedagogu ka realizuar 200 orë mbi normën e ngarkesës në auditor</p>
Konkluzioni	<p>Kjo situatë ka ardhur për shkak të:</p> <p>-Mos zbatimit të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik të institucioneve Publike të Arsimit të Lartë.</p> <p>-Dhe problemeve në interpretim që ka shkaktuar Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut	I lartë
Rekomandimi	Strukturat përkatëse ne Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nëpërmjet rishikimit të Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", të informojnë të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik për rastin e pagesës së orëve mësimore të realizuara jashtë auditorit, kur tejkalohet norma e ngarkesës

Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	<i>Ky rekomandim është për strukturat në MASR</i>
Statusi i rekomandimit	<i>I pranuar nga drejtuesit e universitetit</i>

Dhe për vitin akademik 2018-2019 u përpilua tabela përmbledhëse e orëve të realizuara nga stafi akademik me kohë të plotë, pjesë e dosjes së auditimit.

Në fillim të vitit akademik 2018-2019 senati akademik në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", ka marrë vendim që pedagogët të paguhen deri në 200 orë mbi normën e ngarkesës. Ky vendim është marrë paraprakisht për shkak të planifikimit të fondeve për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

Siç shikojmë në tabelën sa sipër ka pedagogë që kane realizuar orë dhe jashtë auditorit. Në këtë Rast MASR duhet të rishikojë udhëzimin.

Opinion

Sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon në përputhje me kuadrin rregullator, përjashtuar rastin e pagesave për orët e paguara mbi normën e ngarkesës, gjë cila ka ardhur si rezultat i

-Mos zbatimit të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik të institucioneve Publike të Arsimit të Lartë.

-Dhe problemeve në interpretim që ka shkaktuar Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".

Përmirësimi i këtyre sistemeve bëhet i mundur me zbatimin e rekomandimeve që do të lejë grupi i auditimit

11.- Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë në lidhje me funksionimin e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit Ka realizuar funksionet e tij në zbatim të kërkesave të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015, nenet 47, 48 e 49.

Në vitin fillim të vitit 2018 bordi i administrimit për punonjësit e emëruar nga Ministri është ndryshuar. Aktualisht përbërja e Bordit të Administrimit është:

	Pozicioni	Profesioni	Përfaqësues të:
	Kryetar Bordi	Ekonomiste Pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë	IAL
	Nënkryetar	Doktor i Shkencave Bujqësore Specialist kërkues në sektorin e Prodhimit të Farërave pranë Drejtorisë së Teknologjive Bujqësore	MASR
	Anëtar	Mjek Veterinar Sekretar i degës Korçë në Kryqin e Kuq Shqiptar	MASR
	Anëtare	-Specialiste Financiare-Kostoiste në Institutin e Ndërtimit pranë Departamentit të Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse, Sektori i Menaxhimit Financiar -Pedagoge pranë Universitetit Ekonomik të Agrobiznesit, Departamenti Financë-Kontabilitet	MASR

	Anëtar	Inxhinier metalurgjie Drejtor Rajonal i Kompanisë Sigal	MASR (përfaqësues i studentëve)
	Anëtar	Pedagog në Fakultetin e Bujqësisë	IAL
	Anëtar	Ekonomist Pedagog në Fakultetin e Ekonomisë	IAL
	Sekr. Bordi	Ekonomiste Përgjegjëse e Sektorit të prokurimeve	

Siç shihet Bordi Administrimit ka në përbërje të tij punonjës me integritet dhe formim të lartë arsimor. Nuk ka një vendim të Bordit të Administrimit për emërimin e sekretarit të Bordit. Këtë detyrim e mbulonte vullnetarisht një punonjëse e universitetit

Sekretare e Bordit nuk paguhej për punën që bënte. Të shikohet forma dhe mundësia e pagesës për sekretaren e Bordit të Administrimit.

Sqarim: Sipas pretendimeve të ngritura nga drejtuesit e Universitetit të paraqitura me shkresën nr.2/1, datë 10.01.2020, Bordi i Administrimit ka marrë vendimet përkatëse (Bashkengjitur kësaj shkrese) për pagesën e sekretares së Bordit.

U lexuan disa procesverbale e vendime të bordit të administrimit nga ku rezulton se ato janë sipas kërkesave të Ligjit për arsimin e lartë.

Për vitin 2019 Bordi i administrimit ka marrë 29 vendime, ku me të rëndësishmet janë:

- Miratimi i ndarjes së grantit buxhetor
- Miratimi i regjistrimit të prokurimit publik dhe detajimit të të ardhurave për vitin 2019.
- Miratimin e ndryshimeve për studentët që përfitojnë bursë dhe përjashtohen nga tarifa e shkollimit sipas akteve ligjore e nënligjore "Paketa studentit"
- Miratimi bursave për vitin akademik 2018-2019
- Miratimi i numrit të punonjësve të universitetit sipas niveleve
- Miratimi i nivelit të pagave të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të universitetit.
- Miratimi i programit buxhetor vjetor dhe afat mesëm për periudhën 2020-2022
- Miratimi i dhënies së ambienteve me qira,

Dhe një sërë vendimesh të tjera.

Opinion

Për periudhën e audituar BA në aktivitetin e tij, në zbatim të akteve ligjore, si organi më i lartë kolegjal administrativ ka garantuar përmbushjen e misionit të Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

PËR GRUPIN E AUDITIT